

*Fjala e hapjes: Përrurimi VENDBANIMET E KOSOVËS*

*Justina Shiroka - PULA, Anëtare Korrespondente; Sekretare e Seksionit të Shkencave Shoqërore (SSSH), Prishtinë, 17.03.2021*

**I nderuar kryetar i Akademisë Akademik Mehmet Kraja  
I nderuari Nënkyetar i Akademisë Akademik Bajraktari  
E nderuara zonja Limani Sekretare Shkencore e Akademisë  
Të nderuar anëtarë të akademisë  
Autor, Zonja dhe zotërinj  
Mysafirë të nderuar**

Kam nderin, që sot në mesin e Akademikëve, të shkencëtarëve dhe të profileve të ndryshme dashamirë të librit, të hap **përrurimin e “Leksikonit të vendbanimeve të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale”**, në tri vëllime, në 2.023 faqe

Pas përfundimit me sukses të projektit “Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës – Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale” dhe punës shumëvjeçare të ekipit të madh të bashkëpunëtorëve dhe të specialistëve të fushave të ndryshme të shkencave gjeohapësinore dhe fushave të tjera, të udhëhequr nga akademik Hivzi Islami, doli në dritë kompleti i plotë në tri vëllime që sot po e përrurojmë.

Leksikoni **Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës** ka sjellë risi, si nga qasja Hartuese Metodologjike, fakteve dhe informatave të rëndësishme nga terreni, dhe të dhënave burimore dhe origjinale shkencore për evolucionin cilësor dhe sasior të vendbanimeve të Kosovës.

Prandaj, Leksikoni **Vendbanimet urbane dhe rurale të Kosovës, është një vepër Kapitale, jashtëzakonisht me vlerë të madhe, e cila ka** ndjekur një qasje Bashkëkohore teorike shkencore duke konsistuar në përfshirjen e vështrimit intelektual dhe profesional.

Akademik Hivzi Islami, me qasjen e tij shkencore dhe profesionale në hartimin e këtij botimi ka angazhuar një numër të madh ekspertësh të shkencave gjeohapësinore, demografë, historianë, arkeologë, sociologë dhe ekspertë të tjerë.

Prandaj, me këtë rast, i shpreh falënderimin tim **Akademik Islamit, Redaksisë, Autorëve dhe Recensentëve** për këtë botim të tipit Enciklopedik **që Kosova, deri me tani, ka pasur mungesë, të një botimi kompleks shkencor për vendbanimet.**

Andaj, Zonja dhe zotërinj,

**Botimi i “Leksikonit të vendbanimeve të Kosovës - Tabloja fizike-hapësinore, demografike dhe funksionale” në tri vëllime**

***Vendbanimet Urbane, vëllimi i parë***

***Vendbanimet Rurale-Shkronja A-LL, vëllimi i dytë, dhe***

***Vendbanimet Rurale-Shkronja M-ZH, vëllimi i tretë***

Plotëson mungesën e informatave rreth rrjedhave të rritjes dhe të zhvillimit të vendbanimeve të Kosovës, si dhe rreth njohurive sistematike për dinamikën e jetës, bazuar në metodologjinë bashkëkohore shkencore.

Në fund, duhet të them se, ky botim jo vetëm që është një botim Multidisciplinar, por është një **botimi kapital kompleks shkencor dhe profesional për vendbanimet**, që paraqet një ENCIKLOPEDI në vetvete.

Prandaj, me këtë rast i falënderohemi dhe i dëshirojmë akademik Islamit dhe bashkëpunëtorëve të tij punë të suksesshme **në vazhdimin e projekteve të tjera Multidisciplinare.**

Ju faleminderit!